



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Dalibor Jevtić, Kryetar i Komunës së Shtërpcës Predrag Grbić, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtërpcës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 09.12.2022
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Branko Mirić, Zyrtar për monitorim të komunave	Nr. 020-218/2
Lënda:	Konfirmim i ligshmërisë së aktit të Komunës së Shtërpcës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të komunës së Shtërpcës	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr. 01-020/08-16134/22/22 për plotësimin dhe dryshimin e Vendimit Nr. 01-020/08-2459/22 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtërpcës

I miratuar më datë: 29.11.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.12.2022

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.11.2022, ka miratuar *Vendimin Nr. 01-020/08-16134/22/22 për plotësimin dhe dryshimin e Vendimit Nr. 01-020/08-2459/22 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Shtërpcës.*

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Shtërpcës është bazuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitat të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për këshillat komunale për siguri në bashkësi.

*Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Shtërpcës me datë 29.11.2022, me 14 vota për, 1 kundër dhe 0 abstenim.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministartstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za:	Dalibor Jevtić, gradonačelnik opštine Štrpce Predrag Grbić, predsedavajući Skupštine opštine Štrpce	
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS-u Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Venera Çerkini, zam. generalnog sekretara MALS-a	
Od:	Besim Myrtezani, zam. rukovodioca pravnog odeljenja i monitoring opština	Dana: 09.12.2022.
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitoring opština Branko Mirić, službenik za monitoring opština	Br. 020-218/2
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Štrpce	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine Štrpce	

Uvaženi gradonačelnice,  
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa Uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2021 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstava, pravno odeljenje i monitorisanje opština ministarstva administracije lokalne samouprave, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti, kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, sledeći opštinski akt:

Odluka br. 01-020/08-16134/22 o izmeni i dopuni Odluke br. 01-020/08-2459/22 o osnivanju opštinskog odbora za bezbednost u zajednici u opštini Štrpce
Usvojena dana: 29.11.2022.
Predložena na razmatranje u MALS-u dana: 06.12.2022.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta, u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi.

## Obrazloženje

Skupština opštine Štrpce na sednici održanoj dana 29.11.2022, usvojila je *Odluku br. 01-020/08-16134/22 o izmeni i dopuni Odluke br. 01-020/08-2459/22 o osnivanju opštinskog odbora za bezbednost u zajednici u opštini Štrpce.*

MALS konstatuje da Odluka koju je donela Skupština opštine Štrpce, zasnovana je na članu 12. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi i odredbama Administrativnog uputstva br. 27/2012 MUP - 03/2012 MALS o opštinskim odborima za bezbednost zajednica.

*Odluka je usvojena na sednici Skupštine opštine Štrpce, dana 29.11.2022, sa 14 glasova za, 1 protiv i 0 uzdržanih.*

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.